


MENDO PARA SE TË VOZITISH



BRIDGESTONE



FIA Foundation
for the Automobile and Society



MENDO PARA SE

MENDO PARA SE TË VOZITISH është iniciativë globale për siguri në rrugë, e Fondacionit FIA, korporacionit Bridgestone dhe auto-moto klubeve botërore.

Kjo kampanjë promovon mesazhe të thjeshta për siguri në rrugë:

- ⊕ potencimin e veprimeve të shkurtra, që mund t'ju shpëtojnë jetën;
- ⊕ Identifikimin e faktorëve kryesor të rrezikshëm, që rezultojnë me aksidente fatale të trafikut.

Informata me të gjëra mund të gjeni në:

www.thinkbeforeyoudrive.com

TË VOZITISH

Përcjelli këshillat e ekspertit tone për siguri në rrugë - kukullës për testim, e cila rregullisht i ekspozohet lëndimeve, të cilat shpresojmë se, kurrë nuk do t'ju ndodhin...



Mendo. Çdoherë përdor ulëse për fëmijë

Mendo. Çdoherë përdor rripin e sigurisë


Mendo. Rregullo mbështetësen e kokës

Mendo. Kontrolllo gjendjen e gomave

Mbaj mend, **MENDO PARA SE TË VOZITISH**

MENDO. GJITHMONË PËRDOR


Çka ndodh nëse nuk...



- ⊕ Përplasja, me vetëm 10 km në orë, mund të mbysë fëmijë të pa lidhur.
- ⊕ Kurrë mos udhëto me fëmijë në prehrin tënd ose në duart tuaja - në aksident, pesha e fëmijës zmadho het deri në 20 herë dhe është e pamundur ta mbani atë.
- ⊕ Kurrë mos vendos ulësen për fëmijë në pozitë mbrapse në karrigen e përparme, të pajisur me jastëk ajri.

ULËSE PËR FËMIJË

Çka duhet bërë...



- ⊕ Ulëset për fëmijë shpëtojnë jetë.
- ⊕ Përdorni ulëse dhe rrip mbrojtës, të përshtatshëm për madhësinë dhe peshën e fëmijës tuaj.
- ⊕ 90% të lëndimeve mund të mënjanojnë, nëse rripat mbrojtëse përdoren në mënyrë të rregullt - duke i përcjellur me vëmendje instruksionet për vendosjen e tyre.

MENDO PARA SE TË VOZITISH

MENDO. ÇDOHER PËRDOR


Çka ndodh nëse nuk...



- ⊕ Pa rrip të lidhur, në rast të aksidentit, do të përplaseni në qelqin e përparmë, tablonë kontrolluese dhe në timon.
- ⊕ Udhëtarët e pa lidhur në veturë, rrezikojnë të lëndohen ose të vdesin në rast të aksidentit.
- ⊕ Rreziku i lëndimeve serioze, ose vdekjes, për udhëtarët e pa lidhur në karriget e prapme është tre herë më i madh se, sa për udhëtarët e lidhur.

RRIPIN PËR LIDHJE

Çka duhet bërë...





- ⊕ Rripat e sigurisë shpëtojnë jetë. Çdoherë sigurohu se, udhëtarët janë lidhur me rrip.
- ⊕ Rripi i zmadhon gjasat për mbijetesë deri në 60% në rast aksidenti.
- ⊕ Lidhu gjatë secilit udhëtim, pa marrë parasysh sa i shkurtë është ai.

MENDO PARA SE TË VOZITISH

MENDO. RREGULLO


Çka ndodh nëse nuk...



- ⊕ Lëndimet e qafës janë lëndime më të shpeshta për udhëtarët në veturë.
- ⊕ Lëndimet në qafës mund të jenë shumë të dhimbshme dhe, ndonjëherë, rezultojnë me simptome të cilat zgjasin vite me rradhë pas aksidentit.
- ⊕ Madje edhe simptomat e lehta, dhembja e kokës, forcimi i muskujve dhe marramendja, mund të zgjasin me muaj.

MBËSHTETËSEN E KOKËS

Çka duhet bërë...



- ⊕ Për mbrojtje nga lëndimet e qafës, gjatë secilës hyrje në veturë, duhet të adaptosh mbështetësen për kokë.
- ⊕ Për të qenë sa më efektive, mbështetësja e kokës duhet me qenë sa më afër pjesës së pasme të kokës, kurse maja e mbështetëses duhet me qenë në nivelin e majës së kokës, jo më poshtë se, sa niveli i syve.
- ⊕ Llojet dhe modelet e ndryshme të veturave, ofrojnë nivele të ndryshme të mbrojtjes për mbështetjen e kokës.

MENDO PARA SE TË VOZITISH

MENDO. KONTROLLO


Çka ndodh nëse nuk...



- ⊕ Gomat e harxhuara reduktojnë aftësitë e veturës. Kur gomat janë të harxhuara, nevojitet kohë më e gjatë për frenim në rrugët me lagështi, dhe është prezent rreziku i rrëshqitjes.
- ⊕ Gomat jo të fryera mirë zvogëlojnë kontrollin ndaj veturës, zmadhojnë distancën e frenimit dhe i shpenzojnë më shpejtë gomat e veturës.
- ⊕ Gomat e fryera tej mase, zvogëlojnë kontaktin me rrugën, zvogëlojnë stabilitetin gjatë frenimit dhe vështirësojnë manovrimin.

GJENDJEN E GOMAVE


Çka duhet bërë...



- ⊕ Duhet të kontrolloni gomat, së paku një herë në muaj. Informacioni për shtypjen e saktë të duhur të gomave, mund të gjendet në skajin e derës së vozitësit.
- ⊕ Kontrolllo gomat për shenja të dëmtimit ose plasjeve. Edhe plasaritja më e vogël, duhet të kontrollohet nga ana e specialistit për goma.
- ⊕ Të gjitha gomat kanë indikatorë të nivelit të harxhimit. Këta indikatorë paraqiten në kanalet kryesore të gomave, kur ato harxhohen deri në 1.6 mm. Në rastet e tilla, goma duhet ndërruar.

MENDO PARA SE TË VOZITISH

MENDO. MOS PI GJATË VOZITJES



- ⊕ Vozitja nën ndikimin e alkoolit mbyl.
- ⊕ Mos pi nëse ke ndërmend të vozitsh.
- ⊕ Mos hyn në veturë, nëse vozitësi është nën ndikim të alkoolit.
- ⊕ Alkooli shkakton reaksione të ngadalësuara, vështirësi në vlerësimin e shpejtësisë dhe largësisë, përgjumësi dhe koncentrim të zvogëluar.
- ⊕ Personat, që kanë konsumuar alkool deri natën vonë, mund të jenë mbi nivelin e lejuar edhe mëngjesin e ardhshëm.


MENDO. MOS VOZIT NËN NDIKIM TË MEDIKAMENTEVE



- ⊕ Vozitja nën ndikimin e barërave mund të të mbyt.
- ⊕ Shumë barëra shkaktojnë përgjumësi, ose ndikime tjera të pa dëshiruara. Gjithmonë lexo udhëzimin në shishe, ose në paketimin e barërave, apo konsultohu me mjek.
- ⊕ Efekte tjera të padëshiruara, të shkaktuara nga barërat janë: koncentrim i zvogëluar, reagime të ngadalshme, vështirësi në vlerësimin e largësisë dhe shpejtësisë.
- ⊕ Anestetikët nga dita e operimit, gjithashtu, mund të shkaktojnë vështirësi gjatë vozitjes. Çdoherë sigurohu dikush të të merr nga spitali.
- ⊕ Llojet e drogave, si kanabisi , heroina, ekstazet dhe kokaina, poashtu, shkaktojnë vështirësi në vozitje.

MENDO PARA SE TË VOZITISH

MENDO. MOS PËRDOR TELEFONIN CELULAR GJATË VOZITJES



- ⊕ Biseda në celular, gjatë vozitjes, është e rrezikshme.
- ⊕ Përdorimi i celularit, gjatë vozitjes, mund të ndikojë në aftësinë tuaj për vlerësimin e largësisë, mbajtjen e linjës (drejtimit) së lëvizjes dhe përshtatshmërinë e shpejtësisë.
- ⊕ Nëse është e mundur, çkyqe celularin gjatë vozitjes.
- ⊕ Nëse është e domosdoshme të pranoni thirrje gjatë vozitjes, përdorni vetëm “hands free” celular. Flisni shkurt, mos u fjalosni dhe ndalni veturën, nëse është e mundur.
- ⊕ Kurrë mos shkruani, ose lexoni mesazhe tekstuale gjatë vozitjes.

MENDO. MOS VOZIT SHPEJTË



- ⊕ Shpejtësia tej mase është shkaktari kryesor i aksidenteve të trafikut.
- ⊕ Adapto shpejtësinë, sipas kushteve në rrugë, trafikut dhe kushteve klimatike.
- ⊕ Vozitja shumë afërt veturës para jush, edhe pse me shpejtësi të përshtatshme, është e rrezikshme.
- ⊕ Çdoherë vozisni me shpejtësi, e cila do t'ju mundësojë të ndaleni në suazat e largësisë së volitshme.
- ⊕ Zvogëloni shpejtësinë kur në rrugë ka këmbësorë dhe biçikletistë, fëmijë dhe motoçikleta.

MENDO PARA SE TË VOZITISH

MENDO PARA SE TË VOZITISH është iniciativë globale për siguri në rrugë, e Fondacionit FIA, korporacionit Bridgestone dhe auto-moto klubeve botërore.



www.fiafoundation.com

BRIDGESTONE

www.bridgestone.com



www.amsm.com.mk

Informata më të gjëra mund të gjeni në:

www.thinkbeforeyoudrive.com